

ikubINFO Shpk është kompania më e madhe për enterprise software engineering në Shqipëri.

Me një staf prej mbi 90 zhvilluesish, gjithnjë në rritje, me njohuri dhe eksperiencë të gjerë në fusha të ndryshme, **ikubINFO** po zgjeron aktivitetin e saj me projekte ambicioze si brenda dhe jashtë vendit.

Aktualisht, **ikubINFO** është në kërkim të kandidatëve të motivuar dhe me eksperiencë të cilët dëshirojnë t'i bashkohen grupit të tij të profesionistëve në pozicionin:

Marketing Operations Manager

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të marketingut të cilat kanë si qëllim arritjen e objektivave të kompanisë për të realizuar planin e shitjes.
2. Punon ngushtësisht me shitësit e kompanisë (*Business Development Manager(BDM), Account Manager(AM), Sales Representatives(SR)* etj.,).
3. Harton planin e marketingut në linjë me objektivat e kompanisë.
4. Harton listën e shërbimeve të kompanisë dhe përgatit strategjinë e marketingut në bashkëpunim me BDM, AM, SR dhe stafin tjetër të shërbimeve.
5. Analizon tendencën e tregut, strategjinë e çmimeve dhe mendimet e klientëve dhe rekomandon ndryshime në strategjinë e zhvillimit të biznesit bazuar në analiza konkrete.
6. Krijon dhe mirëmban raporte mbi aktivitetet marketing, efektivitetin e tyre dhe ndikimin që ato kanë mbi biznesin.
7. Bashkëpunon me shitjet (AC, BDM, SR) për të zhvilluar plan strategjik dhe taktik mbi mundësitë e reja të zhvillimit të biznesit.
8. Zhvillon dhe implementon koncepte të reja, modele biznesi, kanale të reja komunikimi dhe partnerë të rinj për të pozicionuar biznesin si lider në industrinë e zhvillimit të *software*.
9. Kryen aktivitete marketingu që promovojnë shërbime të kompanisë si më poshtë:
 - Promovim i faqes së kompanisë duke rritur vizibilitetin në faqet e motorëve të kërkimit.
 - Pjesëmarrje në evente, konferenca me qëllim Outsourcing dhe Shitje.
 - Promovimi i brand-it të kompanisë brenda Evropës.
 - Krijimi dhe ruajtja e marrëdhënieve me rrjetin e grupeve të interesit.
 - Mirëmbajtja e marrëdhënieve me partnerë që do të punojnë outsourcing (në shitje dhe marketing).
 - Përgjegjës për fushatën e email-eve direkte me bashkëpunëtorë të ndryshëm.
 - Publikime në portale me fokus outsourcing për të bërë sa më të njohur kompaninë në vendet e Evropës.
 - Krijon dhe publikon video në YouTube për IkubINFO dhe Outsourcing.
 - Reklamim i kompanisë, kryesisht në LinkedIn.
 - Telemarketing
10. Kryen kërkime për të identifikuar tregje potenciale për shërbime të kompanisë, kompani konkurren të fushës, partnerë potencialë biznesi dhe individë për punësim/bashkëpunim.
11. Ndjek programe zhvillimore të financuara nga organizma të huaj me qëllim zhvillimin e biznesit të outsourcing.
12. Kryen kërkime për të identifikuar kompanitë e ngjashme apo kompanitë e reja me shërbime të ngjashme apo të njëjta me ikubINFO në tregun shqiptar / rajonal.
13. Kryen kërkime për politikën, trajtimin e punonjësve etj. në kompanitë konkurren të si dhe llojet e projekteve dhe teknologjive.

14. Identifikon evente , *workshops* lokale/rajonale etj. ku kompania të marrë pjesë për të rritur dhe forcuar imazhin e saj në komunitetin teknologjik, dhe për tu përdorur për bashkëpunime apo punësime të reja.
15. Përgatit dhe përditëson materiale të përshtatshme për prezantimin e kompanisë në web, mediat sociale, eventet kombëtare dhe ndërkombëtare për teknologji, outsourcing etj.

Edukimi dhe Eksperienca:

1. Diplome universitare (Preferohet – Informatikë, Inxhinieri Kompjuterike, Elektronike, Ekonomi Informatike).
2. Minimumi 2 vite eksperiencë pune në pozicione Marketingu dhe në industry të ngjashme.
3. Njohuri shume të mira të gjuheve Anglisht dhe Italisht.

Aftesi te tjera:

- Aftësi shumë të mira komunikimi.
- Aftësi shumë të mira në shitje dhe negocim.

Kandidatët e kualifikuar duhet të nisin një letër interesi, CV e përditësuar dhe kopje të dokumentave mbështetëse duke përfshirë dhe letrat e referencës në adresën e e- hr@ikubinfo.al me subjektin Marketing Operation Manager

“Informacioni personal që do të vendosni në aplikimin tuaj do të mbrohet dhe përdoret vetëm për qëllime rekrutimi bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008